



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 691/2 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

**V E N D I M**

**Nr.176, datë 30/12/2016**

***Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 47, datë 25.04.2016, "Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016", të Komisionerit***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15, të Ligjit Nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Ligjin Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Ministria e Financës me shkresën Nr.16422/1, datë 07.12.2016, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 47, datë 25.04.2016, "Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

**Vërej se:**

Me Urdhrin Nr. 36/1, datë 22.01.2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar hetimin administrativ, në lidhje mbi verifikimin e informacionit lidhur me transferimin në kuadër të ristrukturimit, të punonjësës \*\*\*\*\* , në pozicionin *Specialist i Sektorit të Mbështetjes së Përdoruesve, Kateg. III-b*, në Drejtorinë e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 47, datë 25.04.2016 "Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të revokojë Vendimin nr. 18, datë 09.02.2016, "Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të transferimit të punonjësës \*\*\*\*\* pranë Sektorit të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave".
2. Të kërkoj nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, të marrë masat për rregullimin e pasojave financiare dhe konkretisht nëpunësës \*\*\*\*\*

duhet t'i mbahet diferenca e pagës ndërmjet kategorisë IV- III-b, për atë pozicion pune që ka mbuluar, për periudhën nga data 05.06.2015 deri në datën 31.01.2016.

3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Komisioneri, me shkresën nr.691 prot., datë 23.11.2016, "*Në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 47, datë 25.04.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*", ka kërkuar informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e këtij vendimi dhe vënien në dispozicion të të gjithë praktikës shkresore që materializojnë zbatimin e tij brenda një afati 10-ditor nga marrja dijani.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Ministrisë së Financave, me shkresën nr.16422/1 prot., datë 07.12.2016, "*Kthim përgjigje*", ka vënë në dijeni Komisionerin në lidhje me masat e marra.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor bashkëlidhur shkresës së mësipërme, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 2 të Vendimit të Komisionerit njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Ministrisë së Financave ka marrë të gjitha masat për rregullimin e pasojave financiare të ardhura në periudhën 05.06.2015 deri 31.01.2016, gjatë së cilës \*\*\*\*\* ka qenë e punësuar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Mbështetjes së Përdoruesit, në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Teknologjisë së Informacionit, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të nivelit minimal të diplomës (të përcaktuar në VKM-në nr. 142 datë 12.03.2014, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*).

Konkretisht, me shkresën nr.3096/3 prot., datë 12.04.2016, "*Njoftim për kthimin vullnetar të shumës*", të Ministrisë së Financave, drejtuar \*\*\*\*\* , është kërkuar marrja e masave për kthimin vullnetar të shumës nga ana e saj. Kjo e fundit, me njoftimin nr.3096/6 prot., datë 28.04.2016, "*Njoftim për kthim vullnetar të shumës*", drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, për dijeni Drejtorisë së Financës është angazhuar që të bëjë kthimin vullnetar prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë bruto në muaj, deri në pagimin e plotë të detyrimit.

Nga komunikimi elektronik i datës 06.12.2016 ndërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Financës në Ministrinë e Financave rezulton se kjo e fundit ka aplikuar ndalesat në pagë për punonjësen \*\*\*\*\* në shumën e specifikuar më sipër.

Përfundimisht, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar arrihet në konkluzionin se Vendimi Nr. 47, datë 25.04.2016, "*Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016*", është zbatuar plotësisht nga ana e subjektit.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të Ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

- 1.** Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 47, datë 25.04.2016, në institucionin e Ministrisë së Financave.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr.47, datë 25.04.2016, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 36/1 prot., datë 22.01.2016”.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**